



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT			
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE			
ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	03-02/DPK	Nr. Prot.	01-1937/16
Dep.		Br. Prot.	
Nr. I faq.		Prot No.	
Broj stranica	02	Data	01-06-2016
Nr. pages		Datum	
		Date	
PRISHTINË			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.05.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1672/15, për znj. Dhurata Hoxha, Këshilltare Politike në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtarja e lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Dhurata Hoxha, Këshilltare Politike në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtarja e lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar një takim me zyrtaren e lartë. Gjatë këtij takimi znj. Hoxha është njoftuar me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarja e lartë, znj. Hoxha ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të bërë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, znj. Hoxha ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve (DPKI.03-02/1841/16) me të cilen vërtetohet se zyrtarja e lartë është larguar nga funksioni person i autorizuar në biznesin private Sh.P.K “Abelardo”. Me këtë rast është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

